

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KARTES SE KREDITIT VISA GOLD

1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

Banka Adresa Numri i Telefonit (*) Adresa e postës elektronike (*) Numri i Faksit (*) Adresa e Web-it	Tirana Bank <i>[Adresa gjeografike e bankës për t'u përdorur nga konsumatori]</i>
(*) ky informacion është opsional për Bankën	

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

Lloji i Kredisë	Kartë Krediti Gold
Vlera totale e kredisë dhe monedha	Karta e Kreditit Visa Classic ofrohet sipas limiteve të kreditimit të mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> deri në 1,875,000 LEK per shuma deri në 6,250,000 LEK ofrohet Karte Krediti e siguruar me depozite bankare me 120% mbulesë në monedhën LEK dhe 130% mbulesë në monedhat EUR, USD
<i>(Nëse është e aplikueshme)</i> Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve	Disbursimi kryhet në kartën e kreditit e lidhur me llogarinë e klientit. Pas disbursimit të limitit të kreditimit të kartës së kreditit, klientit i kalojnë fondet në kartë. Limiti i kreditimit mund të përdoret pasi të merret në dorëzim dhe aktivizohet karta e kreditit. Limiti mund të përdoret për blerje online ose për tërheqje kesh deri në limitin e aprovuar nëpërmjet bankomateve apo sporteleve të Bankës sipas kushteve të përcaktuara nga Banka. Kartëmbajtësi ka të drejtë të tërheqë në kesh me Kartën e tij deri në 50% të limitit të kreditimit.
<i>(Nese eshte e aplikueshme)</i> Kredia eshte ne monedhe te ndryshme nga ajo ne te cilen konsumatori gjeneron te ardhurat.	<input type="checkbox"/> Kredia eshte ne monedhe te ndryshme nga te ardhurat e Klientit; <input type="checkbox"/> Kredia eshte ne te njejten monedhe me te ardhurat e Klientit;
<i>(Nese eshte e aplikueshme)</i> Vlera e keshtit te kredise, e shprehur ne monedhen ne te cilen konsumatori gjeneron te ardhurat, mund te ndryshoje.	Banka do te njoftoje klientin ne rastet kur, si rezultat i ndryshimit te kursit te kembimit, kesti i kredise do te rritet me 20% se kundervlera e keshtit qe do te rezultonte nese do te aplikohet kursi i kembimit midis monedhes se kredise dhe monedhes ne te cilen klienti gjeneron te ardhurat, ne daten e nenshkrimit te kontrates. Klientit I jepet mundesia e konvertimit te kredise ne monedhen qe gjeneron te ardhura. Kerkesa per konvertim do te jete subjekt vleresimi nga ana e Bankes ne perputhje me dokumentacionin financiar qe Kredimarresi do te depozitoje ne momentin e paraqitjes se kerkeses me shkrim dhe, nese plotesohen kushtet e kreditimit, konvertimi do te kryhet me kursin zyrtar te Bankës në ditën që kryhet konvertimi.
Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	24 muaj
Këstet dhe tabela e amortizimit të kredisë (Plani i Shlyerjeve të kartes se kreditit)	Shembull i personalizuar i Planit të Shlyerjes së kartes se kreditit për shumën dhe periudhën e kërkuar nga klienti i bashkangjitet këtij dokumenti. Në përlllogaritjen e kësteve është marrë në konsideratë norma e interesit të aplikuar deri në maturim të kartes. Kartëmbajtësi është i detyruar të shlyejë minimumi 7% të shumës së përdorur të Limitit Kreditues plus interesat dhe komisionet brenda një afati prej 20 ditë kalendarike nga data e nxjerrjes së Llogarisë Mujore. Balanca e detyrimit mund të shlyhet e plotë ose pjesërisht por jo më pak se Pagesa Minimale e përcaktuar në nxjerrjen e Llogarisë Mujore. Masa e shumës minimale 7% e detyrueshme për t'u shlyer çdo muaj. Kjo masa mund të ndryshohet nga Banka dhe do t'i njoftohet Kartëmbajtësit nëpërmjet Llogarisë Mujore të kartës.

NORMA VJETORE E INTERESIT	18.00%
KOHËZGJATJA NË MUAJ	24
SHUMA E KREDISË	250,000
KËSTI MUJOR	12,481
DATA E KËSTIT TË PARË	15/09/2016

PERIUDHA	DATA E KËSTIT	INTERESI	BALANCA E PRINCIPALIT	PRINCIPALI I PAGUAR	INTERESI	KËSTI	PRINCIPALI I MBETUR	PAGESAT PROGRESIVE
1	15/09/2016	18.00%	250,000	8,731	3,750	12,481	241,269	12,481
2	15/10/2016	18.00%	241,269	8,862	3,619	12,481	232,407	24,962
3	15/11/2016	18.00%	232,407	8,995	3,486	12,481	223,412	37,443
4	15/12/2016	18.00%	223,412	9,130	3,351	12,481	214,282	49,924
5	15/01/2017	18.00%	214,282	9,267	3,214	12,481	205,015	62,405
6	15/02/2017	18.00%	205,015	9,406	3,075	12,481	195,610	74,886
7	15/03/2017	18.00%	195,610	9,547	2,934	12,481	186,063	87,367
8	15/04/2017	18.00%	186,063	9,690	2,791	12,481	176,373	99,848
9	15/05/2017	18.00%	176,373	9,835	2,646	12,481	166,537	112,329
10	15/06/2017	18.00%	166,537	9,983	2,498	12,481	156,554	124,810
11	15/07/2017	18.00%	156,554	10,133	2,348	12,481	146,422	137,291
12	15/08/2017	18.00%	146,422	10,285	2,196	12,481	136,137	149,772
13	15/09/2017	18.00%	136,137	10,439	2,042	12,481	125,698	162,253
14	15/10/2017	18.00%	125,698	10,596	1,885	12,481	115,102	174,734
15	15/11/2017	18.00%	115,102	10,754	1,727	12,481	104,348	187,215
16	15/12/2017	18.00%	104,348	10,916	1,565	12,481	93,432	199,696
17	15/01/2018	18.00%	93,432	11,080	1,401	12,481	82,352	212,177
18	15/02/2018	18.00%	82,352	11,246	1,235	12,481	71,107	224,658
19	15/03/2018	18.00%	71,107	11,414	1,067	12,481	59,692	237,139
20	15/04/2018	18.00%	59,692	11,586	895	12,481	48,107	249,621
21	15/05/2018	18.00%	48,107	11,759	722	12,481	36,347	262,102
22	15/06/2018	18.00%	36,347	11,936	545	12,481	24,411	274,583
23	15/07/2018	18.00%	24,411	12,115	366	12,481	12,297	287,064
24	15/08/2018	18.00%	12,297	12,297	184	12,481	0	299,545

Shembull i personalizuar i tabeles se amortizimit per limitin e kerkuar te kartes se kreditit i bashkengjitet ketij materiali.

Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar.

Shembull:

Shembull pagese Karte Krediti GOLD	
Shuma e kredisë	250,000
Komisione kredie	3,500
Totali i interesave të paguar	46,754
Totali i Kredisë/Kësteve të paguara	300,254

Garanci/siguri të nevojshme

Nuk kerkohet garanci pervec rastit kur Karta e Kreditit jepet me cash collateral. Ne kete rast si garanci do te shërbeje depozita bankare e Kartëmbajtësit duke i dhënë mundësinë kredidhënësit (Bankës) të jetë i garantuar në rast se klienti nuk e shlyen kartën e kreditit. Një kartë krediti mund të lidhet vetëm me një depozitë peng. Depozita nuk mund të ndryshohet, thyhet apo tjetërsohet gjatë kohëzgjatjes së kartës së kreditit apo para mbylljes së saj. E njëjta depozitë mund të lidhet me më shumë së një kartë krediti, duke u respektuar në çdo rast shuma maksimale e mbulimit të lejuar. Depozita Junior nuk mund të vendoset si peng depozitë. Depozitat e palëve të treta nuk mund të vendosen si garanci.

Depozita e vendosur si garanci do të regjistrohet në Regjistrin e Barrave Siguruese (RBS) në rast se:

- Shuma e Limitit Kreditues është $\geq 20,000$ EUR (ekuivalenti në LEK, USD)
- Kartëmbajtësi është **pronar/administrator i një kompanie** apo i licencuar si **Person Fizik** pavarësisht shumës së limitit

Ne qofte se klienti disponon me shume se nje produkt te mbuluar me depozite (Cash Collateral/OVD Advantage/Credit Cards) dhe shuma e tyre eshte $\geq 20,000$ EUR (ekuivalenti ne LEK, USD), atehere te gjitha marreveshjet siguruese per kredite e marra te klientit do te bllokohen ne RBS.

3. Kostoja e kredisë

<p>Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredise.</p>	<p>Norma e interesit për kartën e Kreditit Gold është 18%</p> <p>Interesi i aplikuar do të llogaritet duke filluar nga data e nxjerrjes së Llogarisë Mujore të mëparshme deri në datën e nxjerrjes së fundit të Llogarisë Mujore, i aplikuar mbi shumën e përdorur të papaguar/mbartur dhe llogaritet me bazë vjetore 365 ditë me normë interesi fikse mbi numrin e ditëve të shumës së përdorur.</p> <p>Në rast se balanca e llogarisë shlyhet brenda Afatit, do të aplikohet interes vetëm për shumat e tërheqjes në cash.</p> <p>* Banka do të përcaktojë kohë pas kohe nivelin e interesit kontraktor.</p> <p>Ndryshimi i interesit kontraktor do t'i njoftohet Kartëmbajtësit me anë të "Llogarisë Mujore" të muajit përkatës.</p> <p>Norma e re e interesit do të hyjë në fuqi 31 (tridhjetë e një) ditë kalendarike pas këtij njoftimi.</p>														
<p>Norma efektive e interesit (NEI)</p>	<p>Norma Efektive e Interesit (NEI) është 19.44%</p> <p>NEI llogaritet duke u bazuar në normën e interesit kontraktor në ditën e lidhjes të kontratës, shumën, monedhën dhe shpenzime e komisione të tjera të detyrueshme të limitit të kreditimit, si dhe afatin e vlefshmërisë të kartës së kreditit.</p> <p>Ndryshimi i ndonjë prej elementëve bazë në llogaritjen e Normës Efektive të Interesit (NEI) do t'i njoftohet Kartëmbajtësit përpara aplikimit nëpërmjet njoftimit me shkrim të publikuar në ambjentet e Bankës.</p> <p>Shembull i personalizuar i NEI për limitin e kërkuar të kartës së kreditit bashkëngjitet këtij material.</p>														
<p>A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar: -kontratat e sigurimit për kredinë? <i>Nëse kostot e këtyre shërbimeve nuk njihen nga Banka, ato nuk do të përfshihen në NEI.</i></p>	<p>Nuk aplikohet kontrate sigurimi për kartën e kreditit për individë</p>														
<p>Kosto të tjera shtese</p>	<p>Komision Mujor për mirëmbajtje llogarie të lidhur me kartën e kreditit sipas Kushteve të Punës në fuqi.</p> <p>Kur Karta e Kreditit është me garanci depozitën bankare, aplikohet Komision regjistrimi në RBS 1,400 LEK.</p> <p>Nqs në depozite është me shumë se një pronar përfitues, atëherë për çdo njërin prej tyre shtohet vlera prej 400 LEK për bllokim (kur është e aplikueshme)</p> <table border="0" data-bbox="581 1297 1539 1612"> <tr> <td>Blerje në POS të Tirana Bank</td> <td>Pa komision</td> </tr> <tr> <td>Blerje brenda vendit</td> <td>Pa komision</td> </tr> <tr> <td>Blerje jashtë vendit</td> <td>Pa komision</td> </tr> <tr> <td>Tërheqje Cash në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank</td> <td>2% (min LEK 400)</td> </tr> <tr> <td>Tërheqje Cash jo në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank brenda vendit</td> <td>3% (min LEK 400)</td> </tr> <tr> <td>Tërheqje Cash jo në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank jashtë vendit</td> <td>3% (min LEK 400)</td> </tr> <tr> <td>Komision printimi i Llogarisë Mujore me kërkesë të klientit</td> <td>100 LEK / llogari mujore</td> </tr> </table>	Blerje në POS të Tirana Bank	Pa komision	Blerje brenda vendit	Pa komision	Blerje jashtë vendit	Pa komision	Tërheqje Cash në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank	2% (min LEK 400)	Tërheqje Cash jo në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank brenda vendit	3% (min LEK 400)	Tërheqje Cash jo në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank jashtë vendit	3% (min LEK 400)	Komision printimi i Llogarisë Mujore me kërkesë të klientit	100 LEK / llogari mujore
Blerje në POS të Tirana Bank	Pa komision														
Blerje brenda vendit	Pa komision														
Blerje jashtë vendit	Pa komision														
Tërheqje Cash në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank	2% (min LEK 400)														
Tërheqje Cash jo në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank brenda vendit	3% (min LEK 400)														
Tërheqje Cash jo në rrjetin e ATM/POS të Tirana Bank jashtë vendit	3% (min LEK 400)														
Komision printimi i Llogarisë Mujore me kërkesë të klientit	100 LEK / llogari mujore														
<p>Kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë</p>	<p>Komisioni vjetor i kartës së kreditit Gold 3,500 Lek</p>														
<p>Kostot në rastin e pagesave me vonesë</p>	<p>Në rast të mospagimit në kohë të pagesës minimale të kartës së kreditit, Banka aplikon një penalitet prej 10% mbi normën e interesit të aplikuar. Llogaritja bëhet mbi shumën e papaguar për periudhën në të cilën nuk është shlyer detyrimi nga klienti.</p>														

4.Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

Shlyerja (Pagesa) e kredisë para afatit të maturimit.	Në rast të shlyerjes së plotë të shumës së përdorur brenda “periudhës së pagesës pa komisione”, individit nuk do t’i llogaritet interes standart mbi shumën e përdorur të paguar por vetëm mbi shumën e përdorur për tërheqje cash, pasi për këtë lloj transaksioni interesi standart llogaritet që në ditën e kryerjes së transaksionit. Në rast se karta e kreditit është e mbuluar me garanci depozitë dhe depozita është e bllokuar në Regjistrin e Barrave Siguruese (RBS), atëherë klienti do të ngarkohet me shpenzimet e zhblokimit të depozitës në RBS
E drejta për t’u tërhequr	Kartëmbajtësi ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e lidhur pa dhënë ndonjë arsye, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Bankës brenda një periudhe kalendarike 14 (katërmëdhjetë) ditore nga dita e lidhjes së Kontratës. Në qoftë se Kartëmbajtësi tërhiqet nga kontrata pas marrjes dhe përdorimit të kartës, kontrata do të quhet e zgjidhur ditën që Kartëmbajtësi shlyen plotësisht detyrimet e kartës të njoftuara nga Banka.
Mundesia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)	N/A
Produkte/Sherbime shtese	Llogari rrjedhese e lidhur me karten e kreditit
<i>Nëse është e aplikueshme</i> Banka ka të drejtën e kompensimit, në rastin e shlyerjes së kredisë para afatit të maturimit.	N/A
Informimi në rast refuzimi të kredisë	Banka informon konsumatorin, menjëherë dhe pa komisione, nëse një aplikim për kredi është refuzuar, duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.
Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit në rastin e ndryshimeve të kushteve, të cilat sjellin pasoja në baze të kontratës.	Menyra e njoftimit dhe menyra e marrjes së pëlqimit është me shkrim dhe është një nga pikat e kontratës së kredisë.
Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt bankës	Ankese me shkrim pranë çdo dege të Tirana Bank pranë personave përgjegjës ose telefonon 0800 68 68 ose 04-2277700 (nëse telefononi nga celulari ose jashtë vendit), 24 ore/7 dite të javës. Pranë çdo dege do të gjeni formularet e ankesave si dhe kutite përkatëse të mbledhjes së ankesave.
Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	<i>Ky informacion është i vlefshëm prej datës .../.../... deri në datën .../.../...</i> 7 dite (kalendarike) nga data e marrjes në dorezim

Konsumatori
(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(Emër Mbiemër, Firma)

Shembull ilustrues për Rrezikun e kursit të këmbimit për kredinë në monedhë të ndryshme nga ajo e gjenerimit të të ardhurave

(Tekst sqarues për konsumatorin kur kredia është në monedhe të ndryshme nga të ardhurat)

Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit do të shkaktojte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çojnë në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë, në kthimin e kredise në statusin "me probleme" dhe mund të përfundojnë në fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimit nga ana e bankes.

Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmeri apo angazhim ligjor nga kredidhënia apo kredimarresi.

Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, nepermjet nënshkrimit të këtij dokumenti verteton se: 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredise; 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga levizjet në kursin e këmbimit; 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.

Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që ben banka për dhenien e kredise të konsumatori, por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhenien e kredise dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plote për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.

Te dhena për kredinë në monedhe të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave

Kredimarresi:	Emer Mbiemer
Kredidhënia:	Tirana Bank
Lloji i kredise:	Karte Krediti Gold
Kohezgjatja e kredise:	24 Muaj
Vlera e kredise:	250,000
Njësia monetare:	Lek
Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues	125
Kundervlera e kredise në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat	2,000
Norma efektive e interesit:	19.44%
Indeksi orientues/norma referencë:	N/A
Marzhi:	18%
Të ardhurat mujore (bruto/neto) të huamarresit në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit):	450 EUR

Tabele 1. Kesti i kredise dhe raporti i vlerës së kstit të kredise ndaj të ardhurave (në %), sipas skenareve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit.

Skenari	Kursi i këmbimit	Vlera e kstit e shprehur në monedhën e kredise	Kundervlera e kstit në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat	Të ardhurat (mesatare mujore e tre viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen	Raporti i vlerës së kstit ndaj të ardhurave
Kursi i këmbimit nuk ndryshon	0.007863	12,481	98	450	22%
Nënçmimi i kursit të këmbimit me 5%	0.008257	12,481	103	450	23%
Nënçmimi i kursit të këmbimit me 20%	0.009436	12,481	118	450	26%

Klienti
(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)

(Emër Mbiemër, Firma)